



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

VE N D I M

Nr. 48, datë 14.05.2020

**“PËR**

**MIRATIMIN E PRISHJES SË DETYRUAR TË GODINAVE TË QENDRËS SOCIALE “TË QËNDROJMË SË BASHKU” DHE “KOPSHTI NR. 42”, NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË, SI REZULTAT I DËMTIMIT NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 23, pika 11, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55, pikat 4 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenet 34-35, të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Vendimit nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, Vendimit nr.219, datë 21.03.2017, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pjeshme (pjesa e parë dhe pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njësisë Administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, të Qarkut të Tiranës”, të ndryshuar, Vendimit nr. 165, datë 19.02.2020, të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e njësisë zbatuese për projektimin, rindërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve arsimore”, shkresave me nr. 4169/2 prot., datë 28.01.2020 dhe nr. 4170/2 prot., datë 28.01.2020, të Institutit të Ndërtimit drejtuar Bashkisë Tiranë, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Prishjen e detyruar të godinës Qendra Sociale “Të qëndrojmë së bashku”, e ndodhur në rrugën “Konferenca e Pezës”, me numër pasurie 5/25, ZK 8240, bazuar në oponencën teknike të aktekspertizës së thelluar të Institutit të Ndërtimit, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Prishjen e detyruar të godinës “Kopshti nr. 42”, në pronësi të Bashkisë Tiranë, e ndodhur në rrugën “Nikolla Tupe”, me numër pasurie 2/269, ZK 8270, bazuar në oponencën teknike të aktekspertizës së thelluar të Institutit të Ndërtimit, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit merr të gjitha masat për ndërhyrjen dhe prishjen e objekteve të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi.
4. Policia Bashkiake, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, mbështesin Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit për ndërhyrjen dhe prishjen e objekteve.
5. Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar të marrin masat përkatëse për përditësimin e inventarit financiar, listës dhe dokumentacionit të pronave të paluajtshme të Bashkisë Tiranë, sipas parashikimeve të legjislacionit

në fuqi që rregullon rregjistrimin e pasurive të paluajtëshme, si edhe menaxhimin financiar dhe kontrollin.

6. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, njofton 24 orë përpara ndërhyrjes për prishjen e objektit, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë. Ndërhyrja për prishjen e objekteve bëhet në prani të përfaqësuesit të prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë dhe Policisë së Shtetit.

7. Për ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të parashikuara në pikën 3, të këtij vendimi, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të kërkojë asistencën dhe bashkëpunimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

8. Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit ndjekin procedurat për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit për leje ndërtimi (prishjen e ndërtimit të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore), sipas parashikimeve të vendimit nr. 887/2019, të Këshillit të Ministrave.

9. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet menjëherë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

10. Ngarkohen Kryetari Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Policia Bashkiake, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik dhe Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETARI  
  
TONI GOGU

